

AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ATLAS MEKANIK” sh.p.k

Themeluesit qe nenshkruajne me poshte jane si vijon:

Z. HAKAN METIN, i datelindjes 05.03.1971, atesia Nazim, lindur ne Zonguldak-Turqi dhe banues ne Don Bosko Prane Vizion Plus Pll.9 Shk.1 K.3 Tirane, identifikuar me pasaport nr. U23766881 dhe nr personal H13305001C me Leje qendrimi nr 117731, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Z. ALI OSMAN CUKURCAYIR, i datelindjes 01.01.1990, atesia Hayrettin, lindur ne Cildir – Turqi dhe banues ne Ugur Mumcu Mah. 2271 Sk. No: 13, Sultangazi, Stamboll identifikuar me pasaport nr. U26654943 dhe nr personal 26585621522, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Z. CUMALI AKA, i datelindjes 04.05.1989, atesia Abdullah lindur ne Gerger-Turqi dhe banues ne Kayabasi Mah. Kayasehir bulv. Sogutozu sk. Seyran sehir sitesi A blok D 14, Basaksehir Stamboll, identifikuar me pasaport nr. U12234150 dhe nr personal 22222078612, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Qe ne vijim do te quhet Ortaku i Shoqerise “ATLAS MEKANIK” sh.p.k

Sot me date **22.02.2024**, bazuar ne vullnetin e tij te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, vendosi te themelloje Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:


Kreu I
OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK
Neni 1
Objekti i shoqerise

Shoqeria Tregtare “ATLAS MEKANIK” sh.p.k, ka si objekt veprimtarie:

- 1- Konsulence ne fushen e tregtise per pjese mekanike dhe pjese kembimi per makineri industriale. Shit-blerja te cdo lloj valvule, saricineske, dhe pjeseve perberese te tyre, te boteve te gazit natyror si dhe materialeve te sistemit te ngrohjes, hidrosanitareve, sistemit kundra zjarrit dhe cdo produkt celiku. Prodhimi i tubacioneve dhe pjeseve mekanike per hidrocentrale, turbina etj.
- 2- Mund te hyje ne tratativa dhe biznese me shoqeri te tjera qe kane te njejtin objekt veprimtarie per te realizuar fitime ne fushat e permendura me lart. Marrja pjese neper ankande dhe tendera, si dhe te beje sherbime qe kane lidhje me objektin e veprimtarise se saj. Pregatitja e projekte investuese dhe trajnime fizibilituese, si dhe t’i menaxhoje ato.
- 3- Te Perfitoje, transferoje, te marre apo jape me qera, te bleje dhe shese, si dhe te kontraktoje, te drejten e markes, patentes, licences, dhe te drejtat e tjera qe jane te ngjashme me keto.
- 4- Shoqeria, sic mund te ushtroje punet qe tregohen ne objektin e veprimtarise se saj, brenda dhe jashte vendit, ashtu edhe mund te marre pjese, te perfitoje apo te transferoje nga/te palet e tjera, mund te marre pjese ne kapitalet e personave juridike dhe fizike, te vendit apo te huaj, te krijuar ose qe krijohen me qellim tregtie, industrie, etj., ne lidhje me keto fusha



1



Neni 2
Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise

Ortakët vendosen që shoqëria të emërtojë "ATLAS MEKANIK" sh.p.k
Selia juridike e Shoqërisë ndodhet në, Rruga Mulliri i Vjeter, Gjakaj, Nr pasurie 55/20 , Nd. 7,
Vore.

Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjenci në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

Neni 3
Forma Juridike

1. Shoqëria është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe legjislacionit shqiptar në fuqi
2. Me vendim të ortakëve mund të ndryshojë formën juridike të Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijohen premisa me të favorshme për funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Në këto rast ortakët do të pershtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë, si dhe do të bëjnë regjistrimin e saj në regjistrin tregtar, në organet kompetente shqiptare.
3. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe në përputhje me ligjin.
4. Shoqëria do të ketë vullnet të saj.

Kreu II
TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA
Neni 4

Te drejtat e Shoqërisë dhe të Ortakut

1. Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshtrojë kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.
2. Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortak në një shoqëri tjetër ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar.
4. Shoqëria përgjigjet ndaj të tjerëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqëror të derdhur dhe me të mirat e pasurisë së saj.
5. Ortaku merr pjesë në administrimin e veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vetëm ose nëpërmjet përfaqësuesve të tij.
6. Ortaku ka të drejtë të marrë të gjitha informatat që kanë të bëjnë me veprimtarinë prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare të shoqërisë, si bilanci, llogaritë ekonomike etj.

Neni 5
Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar.

Kreu III
KAPITALI THEMELTAR
Neni 6 Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar është **100.000 (njëqind mijë) Leke**. 3 (tre) kuota gjithsej.

Ortaku i shoqërisë është:

1. **HAKAN METIN**, zotëruar 1 (një) kuota me vlerë 50.000 lek, që përfaqëson **50% (pesëdhjetë për qind)** kapitalin themeltar të shoqërisë;



2



2. **ALI OSMAN CUKURCAYIR**, zotërues 1 (nje) kuote me vlere 25.000 lek, qe perfaqeson **25% (njezet e pese perqind)** kapitalin themeltar të shoqërisë;
3. **CUMALI AKA**, zotërues 1 (nje) kuote me vlere 25.000 lek, qe perfaqeson **25% (njezet e pese perqind)** kapitalin themeltar të shoqërisë;

Kreu IV
PERSONALITETI JURIDIK

Neni 7

Shoqeria fiton personalitetin juridik ne ditën e rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar ne Qendren Kombetare te Biznesit, si dhe fillon veprimtarine e saj me marrjen e licences te ushtrimit se veprimtarise.

Kreu V
ADMINISTRIMI

Neni 8

Shoqeria do te administrohet nga administratori **HAKAN METIN** i cili perfaqeson shoqerine ne marredheniet me te tretet per nje periudhe **5 (pese)** vjecare dhe me te drejte rizgjedhje. Administratori mund t'i delegoje kompetencat e tij me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.

Kreu VI
DISPOZITA TE TJERA

Neni 9

Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortakut te saj, ta ndaje si dividend apo ta shtoje ne kapitalin e shoqerise. Ky Akt shtypet dhe nenshkruhet ne 2 (dy) kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore. Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Ortaku Themelues

HAKAN METIN

Hakan METIN
[Signature]

ALI OSMAN CUKURCAYIR

Ali Osman Cukurcayir
[Signature]

CUMALI AKA

Cumali AKA
[Signature]